

Titulli i lëndës: Letërsi gjermane: Mesjeta deri te Humanizmi

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Letërsi gjermane: Mesjeta deri te Humanizmi
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë studentët do të njoftohen për së afërmi me letërsinë gjermane që nga filltet e saj, pra me Mesjetën, nga e hershmja e deri te fillimi i epokës së re. Përveç zhvillimit historik të letërsisë gjatë mesjetës e që përfshinë një periudhë të gjatë kohore, do të merremi me krijimet e hershme popullore e letrare, me romanet e njohura kalorsiake, poezinë e Minnesang-ut e autorët e rëndësishëm të kësaj periudhe. Thëks të veçantë përbëjnë ndikimet e letërsive të ndryshme në zhvillimin e letërsisë gjermane. Do të merremi edhe me letërsinë e Mesjetës së vonë, si paraprijëse e epokës së re. Njoftohen me periudhat e shek. 16, si Humanizmi, Renesansa, në Gjermani e Evropë, por para së gjithash Reformacioni dhe figura kryesore e tij Martin Luther. Kjo ishte lëvizja më me ndikim e kësaj periudhe në Gjermani dhe e cila u përhap në gjithë botën e shkaktoi ndryshime të mëdha në konceptet e religjionit. Analizohen edhe struktura, llojet dhe sidomos funksionet e letërsisë së këtyre periudhave, ndikimet e Reformacionit, Kundërreformacionit, luftës fshatare, etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

- Lënda Letërsi gjermane: Mesjeta deri te Humanizmi ka për objektiv t'i njohë studentët me letërsinë gjermane që nga fillet e saj e deri te Humanizmi, periudhë e rëndësishme e formësimit të letërsisë gjermane
- Njohja e studentëve me periudha të rëndësishme letrare, kulturore e historike të këtyre shekujve, si: Humanizmi, Renesansa, në Gjermani e Evropë, Reformacioni
- Njohja e studentëve me karakteristikat kryesore të periudhave, prapaskenën historike të zhvillimit të tyre, llojet kryesore letrare, rolin dhe ndikimin e letërsisë popullore,
- Njohja e studentëve me autorët dhe veprat më të rëndësishme të kohës, me ndryshimet që pëson letërsia në këta shekuj
- Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët të analizojnë dhe interpretojnë veprat letrare

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem të këtij kursi (lënde) studenti do të:

- dijë gjërat themelore për letërsinë gjermane që nga fillet e saj e deri te Humanizmi;
- dijë karakteristikat kryesore të periudhave, prapaskenën historike të zhvillimit të tyre, llojet kryesore letrare, rolin dhe ndikimin e letërsisë popullore,
- dijë për autorët dhe veprat më të rëndësishme të kohës, zhvillimin e romanit kalorsiak
- jetë në gjendje të shkruaj një seminar të shkurtër rreth një teme të caktuar nga letërsia;

- të zhvillojë debat me kolegët e tij rreth një teme nga letërsia;
- të jenë në gjendje t'i zbatojnë njohuritë e përvetësuara gjatë punës së tyre të pavarur për analizë të letërsisë

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	22.5
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10min	6	1
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	25	1	25
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			152:25= 6.08 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies do të jetë me studentin në qendër dhe interaktive. Realizimi i programit nga lënda *Letërsi gjermane Mesjeta deri te Humanizmi* bëhet edhe me pjesëmarrjen aktive të vet studentëve, të cilët qysh në fillim të semestrit të parë pasi ju dorëzohet programi përcaktohen për një temë për të cilën do të referojnë me ç'rast do të mësojnë edhe për punën e pavarur për mbledhjen e seleksionimin e materialit të nevojshëm për hartimin e një punimi. Të gjithë studentët punojnë nga një seminar të shkurtër për një temë të cilën ata vet e zgjedhin nga planprogrami. Gjatë orëve të ushtrimeve pastaj, lexohen

	<p>seminaret ose referohen për to dhe zhvillohet debat në klasë për temën dhe periudhën letrare të cilës i takon ajo. Kështu, pjesëmarrja aktive e studentëve bëhet komponentë qenësore në arritjen e objektivave të lëndës dhe arritjen e rezultateve të pritshme.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%; Provimi final 70%.</p> <p>Në këtë lëndë studentët notohen edhe për seminaret që punojnë gjatë vitit.</p> <p>Duke qenë se gjatë orëve referohet për seminaret dhe diskutohet në klasë për periudhën letrare të cilës i takon vepra e poashtu për autorin, krijimtarinë e jetën e tij dhe posaqërisht për veprën në fjalë, të gjitha këto vlerësohen me notë e kjo pastaj mblidhet me notën e provimit përfundimtar që mbahet pas përfundimit të semestrit të II.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat të përgatitura nga Prof. ass. dr. Albulena Blakaj-Gashi 2. Martini, Fritz: Deutsche Literaturgeschichte, Komet, 2003 3. Beutin, Wolfgang: Deutsche Literaturgeschichte. Von den Anfängen bis zur Gegenwart, Metzlersche J.B. Verlagsb; Auflage: 9., verbesserte und erweiterte Auflage, 2019 4. Meid, Volker: Reclam Buch der Deutschen Literatur, Philipp Reclam jun. Verlag Stuttgart, 2004 5. Baumann/ Oberle: Deutsche Literatur in Epochen, Max Hueber Verlag, Ismaning, 2006 6. Brunner, Horst: Interpretationen. Mittelhochdeutsche Romane und Heldenepen, Reclam, 7. Gottfried von Straßburg: Tristan und Isolde, C H Beck, München, 2008 8. Wolfram von Eschenbach: Parzival. Band 1 & 2, 2006 Philipp Reclam jun. GmbH & Co., Stuttgart 9. von Grimmelshausen, Hans Jakob Christoffel: Simplicissimus: Der Abenteuerliche Simplicissimus Teutsch, Kindle Edition 2021
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Brunner, Horst: Interpretationen. Mittelhochdeutsche Romane und Heldenepen, Reclam, - Gottfried von Straßburg: Tristan und Isolde, C H Beck, München, 2008 - Wolfram von Eschenbach: Parzival. Band 1 & 2, 2006 Philipp Reclam jun. GmbH & Co., Stuttgart

Hartimi i planit mësimor

Java

Titulli i ligjëratës

Java 1:	Einführung in das Fach Deutsche Literatur: Mittelalter bis Humanismus
Java 2:	<p>Literatur des Frühmittelalters</p> <ul style="list-style-type: none"> - Germanische Dichtung - Althochdeutsche Literatur unter den Franken Karl der Grosse;
Java 3:	<p>Zaubersprüche und Frühdichtungen</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Merseburger Zaubersprüche", • "Wessobrunner Gebet", • "Muspilli" <p>Die Literatur unter den Otonen</p> <ul style="list-style-type: none"> • Widukind von Corvey "Sachsenchronik", romani "Ruodlieb", Nothker der Deutsche • "Kaiserchronik" und "Rolandlied" si lajmëtar të një periudhe të re.
Java 4:	<p>Heldenlieder:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „Hildebrandslied"
Java 5:	<p>Hochmittelalter</p> <p>Höfischer Epos</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ritterlich - hofischer Epos und der Einfluss der französischen Literatur; • Der frühe ritterliche Roman - Heinrich von Veldeke
Java 6:	<ul style="list-style-type: none"> • Die bekanntesten Autoren und Werke des Hochmittelalters: • Heinrich von Veldeke • Hartmann von Aue "Erec", "Iwein"
Java 7:	<ul style="list-style-type: none"> • Wolfram von Eschenbach "Parzival" • Gottfried von Strassburg "Tristan und Isolde"
Java 8:	<p>Heldenepos</p> <ul style="list-style-type: none"> • Das Niebelungenlied • Vergleich mit albanischen Legenden, gemeinsamkeiten und Unterschiede
Java 9:	<p>Minnesang</p> <ul style="list-style-type: none"> • Die Vaganten - "Carmina Burana",

	<ul style="list-style-type: none"> • Französische Trubadours und deren Einfluss auf dem deutschen Minnesang • Walther von der Vogelweide, Neidhart von Reuenthal
Java 10:	Literatur des Spätmittelalters <ul style="list-style-type: none"> • Meister Eckhart, Neidhart von Reuenthal, • Volkslied – Volksbalade
Java 11:	Humanismus und Renaissance
Java 12:	Erasmus von Rotterdam: „Lob der Torheit“ Johannes Reuchlin
Java 13:	Ulrich von Hutten, der deutsche Humanist Sebastian Brandt: Narrenschiff <ul style="list-style-type: none"> • Das Volksbuch von Dr. Faust • Hans Sachs
Java 14:	Reformation <ul style="list-style-type: none"> • Martin Luther
Java 15:	Wiederholung des gesamten Materials und Vorbereitung für die Prüfung.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.